

VENDIM
Nr.384, datë 6.3.2009

PËR MBYLLJEN E PËRKOHSHME TË VEPRIMTARISË SË NDËRMARRJES
SHTETËRORE “QENDRA NDËRKOMBËTARE E KULTURËS “ARBNORI””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, dhe të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e përkohshme të veprimtarisë së ndërmarrjes shtetërore “Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori””.

2. Nga numri i përgjithshëm i punonjësve të kësaj qendre do të mbetet një njësi prej 5 punonjësish, e cila do të ndjekë realizimin e rikonstruksionit të qendrës, do të arkëtojë në Buxhetin e Shtetit detyrimet kreditore, që të tretët kanë ndaj kësaj ndërmarrjeje (gjithsej 12 953 315 lekë), sipas aneksit nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe do të administrojë inventarët e pasurisë së kësaj qendre.

3. Punonjësit e “Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës “Arbnori””, që dalin të papunë, përfitojnë të drejtën e pagesës, në bazë të nenit 145, të Kodit të Punës, konkretisht:

- Pagë për vjetërsi pune, e përfitojnë 21 (njëzet e një) punonjës, në shumën 2 149 568 (dy milionë e njëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë;

- Pagë për efekt të njoftimit e përfitojnë 75 (shtatëdhjetë e pesë) punonjës, në shumën 4 030 824 (katër milionë e tridhjetë mijë e tetëqind e njëzet e katër) lekë;

- Gjithsej 6 180 392 (gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.

4. Fondi prej 6 180 392 (gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të vitit 2009.

5. Detyrimet, që ndërmarrja shtetërore, “Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori””, ka ndaj institucioneve buxhetore dhe ndërmarrjeve të tjera shtetërore, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të shuhen. Palët, që përfshihen nga shuarja e këtij detyrimi, të bëjnë reflektimet përkatëse në kontabilitetet e tyre dhe në pasqyrat financiare.

Të drejtat e detyrimet e ndërmarrjes shtetërore “Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori””, vërtetohen në llogaritë financiare, të audituara e miratuara në vitin 2008.

6. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

“Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori””
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Nr.prot

Tiranë 31.12.2008

Aneksi nr.1

Detyrimet e QNK-së ndaj të tretëve

në vite

Detyrimet ndaj MTKRS nga vitet	6,966,346	
Detyrim ndaj METE nga vitet	4,324,940	
Detyrim ndaj buxhetit në vite	5,289,801	
Totali	16,581,087	Lekë

“Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori””
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Nr.Prot

Tiranë 31.12.2008

Aneksi nr.2

Detyrimet që të tretët kanë ndaj QNK-së

në vite

Subjektet	Vlera në lekë
Biblioteka angleze 2002-2003	149,387.00
Karabashi qira e papaguar	241,920.00
Alba qira	2,584,777.00
MTKRS	1,083,281.00
INSTAT	194,723.00
Top Albania Radio	145,020.00
Panair Bekim Xhafa	575,000.00
Panair Këshilli Agrobiznesit-KASH	501,200.00
Klubi veror “Ben Domi”	105,000.00
Panair me Elida Co	269,523.00
Qira, Hektor Pustina	105,630.00
Qira, mars Delta Publicity	126,000.00
Qira mars Mc monitoring	103,600.000
Qira mars On Time Concept	135,800.00
Qira Elzana Agolli	19,600.00
Qira Expo Prima	21,700.00
Albatrex qira 9688 \$ *90 lekë/\$	871,920.00
Tatim fitimi teprice debitore në vite	5,365,234.00
Qira antene AMC	354,000.00
Totali në lekë	12,953,315 lekë